



ALMA MATER EUROPAEA
CAMPUS COLLEGE REZONANCA

Tel: +383 38 544-754

URL: <http://www.rezonanca-rks.com>

Ref. Nr. AD-2566/26

Datë 08.07.2026

Në bazë të nenit 108 dhe 109 të Statutit dhe nenit 6 të Rregullores së studimeve të Alma Mater Europaea Campus College "Rezonanca", Senati në mbledhjen e mbajtur më 03.07.2026 miratoi këtë:

KONKURS

për pranimin e studentëve të rinj në vitin akademik 2026/2027

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Alma Mater Europaea Campus College "Rezonanca" në Prishtinë, në vitin e parë të studimeve, në programet e studimeve të integruara, Bachelor dhe Master, në vitin akademik 2026/2027, do të regjistrojë gjithsej 745 studentë në programet e akredituara, sipas tabelës vijuese:

Programi studimor i akredituar	Vendimi për akreditim	Për konkurrim të përgjithshëm	Kuota e rezervuar 20%	Gjithsej
1. Programi Stomatologji (Dr.Stom, 300 ECTS)	1022/26, dt. 29.06.2026	68	17	85
2. Programi BSc Biokimi Laboratorike (180 ECTS)	845/25, dt. 10.07.2025	40	10	50
3. Programi BSc Radiologji Diagnostike (180 ECTS)	928/22D, dt. 15.07.2022	48	12	60
4. Programi BSc Farmaci Komunitare (180 ECTS)	973/26, dt. 19.06.2026	96	24	120
5. Programi BSc Infermieri (180 ECTS)	1392/24, dt. 12.07.2024	120	30	150
6. Programi BSc Fizioterapi (240 ECTS)	1392/24, dt. 12.07.2024	80	20	100
7. Programi MSc Fizioterapi dhe Mjekësi Sportive (120 ECTS)	1392/24, dt. 12.07.2024	24	6	30
8. Programi MSc Farmaci (120 ECTS)	716/25, dt. 20.06.2025	80	20	100
9. Programi MSc Menaxhim i Kujdesit Shëndetësor dhe Ekonomi Shëndetësore (120 ECTS)	583/25, dt. 27.05.2025	40	10	50
GJITHSEJ		596	149	745

2. Në funksion të mbështetjes së vazhdimësisë vertikale të arsimit profesional, krijimit të një kalimi të strukturuar nga arsimi i mesëm profesional në arsimin e lartë dhe valorizimit të përgatitjes paraprake profesionale të kandidatëve, në kuadër të numrit të përgjithshëm të studentëve të përcaktuar për secilin program të studimeve Bachelor, Master dhe për programin e integruar të Stomatologjisë, 20% e vendeve rezervohen për kandidatët që kanë përfunduar me sukses Shkollën e Mesme të Lartë Profesionale "Rezonanca". Kuota e vendeve të rezervuara shpërndahet për secilin program sipas tabelës së mësipërme.

3. Kandidatët që konkurrojnë në kuadër të kuotës së rezervuar u nënshtrohen të njëjtave kushte të konkursit, kritereve të vlerësimit dhe provimit pranues sikurse kandidatët e tjerë. Kuota e rezervuar nuk nënkupton pranim automatik; përzgjedhja bëhet sipas ranglistës së pikëve të fituara brenda kësaj kuote.

4. Vendet e paplotësuara në kuadër të kuotës së rezervuar, pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes për afatin përkatës, kalojnë në kuotën e përgjithshme të programit dhe plotësohen sipas ranglistës së kandidatëve.

5. Të drejtë konkurrimi për regjistrim në programet e studimeve Bachelor dhe në programin e integruar kanë kandidatët që plotësojnë një nga kushtet e mëposhtme:

- Të gjithë të diplomuarit e shkollave të mesme të Kosovës në programet që kanë përfshirë së paku një vit mësimi në Biologji, Kimi dhe Fizikë, me provimin e maturës të kryer, të vërtetuar me diplomë;
- të gjithë të diplomuarit e shkollave të mesme profesionale mjekësore të Kosovës, me provimin e maturës të kryer, të vërtetuar me diplomë;
- të gjithë të diplomuarit e shkollave të mesme të Kosovës në programet pa provim të maturës, që kanë përfshirë së paku një vit mësimi në Biologji, Kimi dhe Fizikë, të vërtetuar me diplomë;
- të gjithë të diplomuarit e shkollave të mesme të shteteve të tjera, të cilët paraqesin certifikatën dhe diplomën për kryerjen e shkollimit 12-vjeçar, në programet e të cilave kanë ndjekur së paku një vit mësimi në Biologji, Kimi dhe Fizikë, me dokumentet e njohura dhe të barasvlerësuara nga Ministria kompetente e Republikës së Kosovës;
- të gjithë të diplomuarit ose të regjistruarit në institucione të arsimit të lartë nga lëmenjtë e shkencave mjekësore, shkencave natyrore ose shkencave të përafërta me programin.

6. Nëse kandidatët nuk i plotësojnë të gjitha kushtet për lëndët Biologji, Kimi ose Fizikë sipas pikës 5 të këtij konkursi, duhet t'i nënshtrohen vlerësimit plotësues nga lënda përkatëse.

7. Në programet Master mund të paraqiten kandidatët të cilët plotësojnë këto kushte:

- kanë të përfunduar nivelin Bachelor në programin adekuat të fushës, të vërtetuar me diplomë;
- të diplomuarit e nivelit Bachelor në programet përkatëse të fushës në shtete të tjera; aplikuesit shtetas të Republikës së Kosovës duhet të paraqesin vendimin për njohjen dhe barasvlerësimin e diplomës nga ministria kompetente.

8. Njohja e certifikatave, përkatësisht diplomave të fituara jashtë vendit, bëhet nga institucioni kompetent i Republikës së Kosovës, sipas legjislacionit në fuqi.

9. Në studime mund të pranohen edhe kandidatët nga shtetet e tjera në kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.

10. Në bazë të parimeve humane dhe përkushtimit për barazi, kandidatëve me aftësi ndryshe, gjatë procesit të aplikimit, u shtohen 5 pikë bonus në vlerësimin total. Statusi i kandidatit me aftësi ndryshe duhet të dëshmohet me dokumentacion përkatës, të lëshuar nga institucionet kompetente.

11. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të AMECC Rezonanca nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në Kolegj pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.

12. Kandidatët për pranim si studentë të AMECC Rezonanca në vitin akademik 2026/27 nuk mund të konkurrojnë në më shumë se një program të studimit.

13. Kandidatët shtetas të huaj mund të konkurrojnë për pranim në programet e studimit të AMECC Rezonanca sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara në Konkursin për pranimin e studentëve ndërkombëtarë për vitin akademik 2026/2027. Pranimi i tyre realizohet brenda numrit të përgjithshëm të studentëve të miratuar për programin përkatës të studimit, përveç rasteve kur me vendim të veçantë përcaktohet ndryshe.

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për programet e studimeve Bachelor dhe programin e integruar bëhet sipas kritereve të përcaktuara më poshtë:

a) Për kandidatët që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe nuk kanë pasur provim të maturës, numri maksimal i pikëve është 100, sipas kritereve vijuese:

- Suksesi në shkollën e mesme vlerësohet deri në 30 pikë.

- Suksesi në provimin pranues vlerësohet deri në 70 pikë.

b) Për kandidatët që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës, numri maksimal i pikëve është 100, sipas kriterëve vijuese:

- Suksesi në shkollën e mesme vlerësohet deri në 30 pikë.
- Suksesi në maturë vlerësohet deri në 20 pikë.
- Suksesi në provimin pranues vlerësohet deri në 50 pikë.

2. Provimi pranues sipas programeve mbahet nga lëndët e paraqitura në tabelën vijuese:

Programi i studimit	Lëndët në provimin pranues*
1. Programi i Stomatologjisë (Dr.Stom, 300 ECTS)	Biologji, Kimi
2. Programi BSc Radiologji Diagnostike (180 ECTS)	Biologji, Kimi
3. Programi BSc Farmaci Komunitare (180 ECTS)	Biologji, Kimi, Matematikë
4. Programi BSc Infermieri (180 ECTS)	Biologji, Kimi
5. Programi BSc Fizioterapi (240 ECTS)	Biologji, Fizikë
6. Programi BSc Biokimi Laboratorike (180 ECTS)	Biologji, Kimi

* Temat dhe fushat përmbajtësore që përfshihen në provimin pranues për secilën lëndë përcaktohen në Programin e provimit pranues për vitin akademik 2026/2027, i cili publikohet në ueb-faqen zyrtare të Kolegjit. Pyetjet e provimit pranues hartohen vetëm nga përmbajtjet e përcaktuara në programin e publikuar.

3. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve është i barabartë, përparësi ka kandidati me sukses më të mirë të përgjithshëm në shkollën e mesme. Nëse barazia vazhdon, merret parasysh suksesi nga lëndët e ngushta profesionale. Nëse edhe pas kësaj kandidatët mbeten me pikë të barabarta, përzgjedhjen e bën Komisioni për pranimin e studentëve të rinj.

4. Për kandidatët që kanë përfunduar një program të arsimit të lartë në një institucion të akredituar ose të njohur, në fushën e shkencave mjekësore, biologjisë, biokimisë ose në fusha të tjera të përafërta me programin për të cilin konkurrojnë, provimi pranues nuk është i detyrueshëm. Pikët e komponentit të provimit pranues përcaktohen në bazë të notës mesatare përfundimtare të studimeve paraprahe, sipas formulës së përcaktuar me këtë konkurs.

Për këta kandidatë, pikët që i atribuohen komponentit të provimit pranues përcaktohen në bazë të notës mesatare të studimeve paraprahe. Për kandidatët që konkurrojnë sipas sistemit me provim të maturës, nota mesatare e studimeve paraprahe shumëzohet me koeficientin 5, në mënyrë që nota mesatare maksimale 10.0 të jetë ekuivalente me 50 pikë nga provimi pranues.

Për kandidatët që konkurrojnë sipas sistemit pa provim të maturës, nota mesatare e studimeve paraprahe shumëzohet me koeficientin 7, në mënyrë që nota mesatare maksimale 10.0 të jetë ekuivalente me 70 pikë nga provimi pranues.

Kandidati që nuk dëshiron të vlerësohet sipas këtij ekuivalentimi ka të drejtë t'i nënshtrohet provimit pranues.

4. Për studimet Master, kandidatët për regjistrim përzgjidhen sipas këtyre kriterëve:

- Suksesi gjatë studimeve në nivelin Bachelor (nota mesatare e studimeve) = maksimum 60 pikë;
- Publikimet, pjesëmarrjet në kongrese, konferenca ose takime profesionale dhe aktiviteti tjetër kërkimor-shkencor = 10 pikë;
- Trajnimet dhe kurset e tjera të kryera = 20 pikë;
- Njohja e gjuhës angleze, e dëshmuar me certifikatë ose diplomë = 10 pikë.

III. AFATET E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR APLIKIM

1. Paraqitja e dokumenteve për afatin e parë bëhet prej **10 korrik 2026 - 18 korrik 2026**, prej orës 09:00 deri në 19:00.

2. Provimi pranues për afatin e parë mbahet më **20 korrik 2026**, sipas këtij orari:

Termimi	Programi
10:00	Programi i Stomatologjisë (Dr.Stom, 300 ECTS)
11:00	Programi BSc Radiologji Diagnostike (180 ECTS)
11:00	Programi BSc Biokimi Laboratorike (180 ECTS)
12:00	Programi BSc Fizioterapi (240 ECTS)
13:00	Programi BSc Farmaci Komunitare (180 ECTS)
14:00	Programi BSc Infermieri (180 ECTS)

3. Paraqitja e dokumenteve për afatin e dytë të konkursit zgjat deri më **15 gusht 2026**, ndërsa provimi pranues për afatin e dytë mbahet më **17 gusht 2026**, në orën 10:00.
4. Paraqitja e dokumenteve për afatin e tretë të konkursit zgjat deri më **19 shtator 2026**, ndërsa provimi pranues për afatin e tretë mbahet më **21 shtator 2026**, në orën 10:00.
5. Paraqitja e dokumenteve për studimet Master bëhet deri më **04 nëntor 2026**.
6. Paraqitja e dokumenteve bëhet në Alma Mater Europaea Campus College “Rezonanca”.
7. Për paraqitje në konkurs për programet Bachelor dhe programin e integruar, kandidatët duhet të dorëzojnë:
- Certifikatën e lindjes;
 - Dëftesat e shkollës së mesme (origjinale, dublikate ose të noterizuara);
 - Diplomën e shkollës së mesme (origjinale, dublikate ose të noterizuar);
 - Dëftesën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinale, dublikate ose të noterizuar);
 - Fletë-aplikacionin, i cili merret dhe plotësohet në Kolegj;
 - Vendimin për njohjen dhe barasvlerësimin e shkollimit të kryer jashtë vendit, të lëshuar nga institucioni kompetent;
 - Kopjen e letërnjoftimit.
 - Për kandidatët që kanë përfunduar një program të arsimit të lartë dhe kërkojnë vlerësimin e komponentit të provimit pranues përmes ekuivalentimit të notës mesatare të studimeve paraprake, kërkohet kopje e noterizuar e diplomës për përfundimin e programit përkatës, ose kopja e noterizuar e transkriptit të notave ose dokumentit tjetër zyrtar të lëshuar nga institucioni përkatës i arsimit të lartë, në të cilin evidentohet nota mesatare e përgjithshme e studimeve të përfunduara. Ky dokumentacion duhet të dorëzohet brenda afatit të aplikimit. Në mungesë të dokumentacionit të plotë dhe të verifikueshëm, kandidati nuk mund të përfitojë nga skema e ekuivalentimit të pikëve.
8. Për paraqitje në konkurs për studimet Master, kandidatët duhet të dorëzojnë:
- Certifikatën e lindjes;
 - Diplomën Bachelor;
 - Fletë-aplikacionin, i cili merret dhe plotësohet në Kolegj;
 - Vendimin për njohjen dhe barasvlerësimin e shkollimit të kryer jashtë vendit, të lëshuar nga institucioni kompetent;
 - Kopjen e letërnjoftimit;
 - Dëshmitë lidhur me publikimet shkencore (kopjet);
 - Dëshmitë lidhur me trajnimet e tjera (certifikata/diploma);
 - Dëshmitë për njohjen e gjuhës angleze (certifikata/diploma).
9. Me rastin e paraqitjes në konkursin për pranim, kandidatët paguajnë 30 euro.
10. Në të gjitha fazat e procedurës së pranimit, kandidatët duhet të kenë me vete dokumentin e identifikimit.
11. Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë.
12. Njoftimet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese publikohen në tabelat e shpalljeve dhe në ueb-faqen zyrtare të Kolegjit.

IV. SHPALLJA E REZULTATEVE PRELIMINARE

1. Rezultatet preliminare të provimit pranues do të publikohen në tabelat e shpalljeve dhe në ueb-faqen zyrtare të Kolegjit jo më vonë se më 21.07.2026.
2. Rezultati preliminar nuk konsiderohet përfundimtar dhe nuk nënkupton automatikisht pranimin e kandidatit. Pas periudhës së ankesave, në rast se ndonjë ankesë aprovohet si e bazuar, mund të ndodhë që kandidatë të tjerë të radhiten më lart në listë dhe të fitojnë më shumë pikë sesa kandidati i pozicionuar sipas rezultateve preliminare.
3. Në listën e rezultateve preliminare, kandidatët identifikohen vetëm përmes kodit të kandidatit, të gjeneruar sipas numrit të dokumentacionit të dorëzuar, me qëllim të ruajtjes së privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

V. E DREJTA DHE AFATI PËR ANKESË

1. Kandidatët që, sipas rezultateve preliminare, renditen si të papranuar kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Kolegj jo më vonë se brenda 24 orëve nga data e publikimit të rezultateve preliminare, konkretisht më 22.07.2026 deri në orën 19:00.
2. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar më sipër, ankesat nuk pranohen. Shqyrtimi i ankesave realizohet menjëherë pas mbylljes së afatit për paraqitjen e tyre dhe bëhet ekskluzivisht nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave i Kolegjit. Vendimet e këtij komisioni janë përfundimtare dhe u komunikohen kandidatëve në formë zyrtare.
3. Kandidatët që nuk janë pranuar mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në Kolegj duke filluar nga data 24.07.2026.
4. Kandidatët të cilët kanë plotësuar kriteret e radhites, por nuk janë përfshirë në listën e kandidatëve të pranuar për shkak të plotësimit të të gjitha vendeve të parapara në programin ku kanë aplikuar, mund të pranohen, me kërkesë të tyre, në programe të tjera studimore brenda Kolegjit ku kanë mbetur vende të lira pas afatit të parë të konkursit. Pranimi bëhet sipas ranglistës së pikëve të grumbulluara, me kusht që kandidatët t'u jenë nënshtruar testeve të njëjta ose të përafërta të provimit pranues.
5. Në programet ku nuk plotësohet numri i kandidatëve të paraparë me këtë konkurs, realizohen afatet pasuese të provimit pranues sipas datave të përcaktuara në pikën III të këtij konkursi.

VI. SHPALLJA E REZULTATEVE PËRFUNDIMTARE

1. Shpallja e rezultateve përfundimtare të provimit pranues bëhet në tabelat e shpalljeve dhe në ueb-faqen zyrtare të Kolegjit, pas shqyrtimit të ankesave, më së largu më 23.07.2026.

VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE TË PRANUAR

1. Regjistrimi i kandidatëve të pranuar bëhet në Administratën e Kolegjit nga data 23.07.2026 deri më 31.07.2026.
2. Kandidatët e pranuar, për regjistrim, duhet të paraqesin:
 - Fletë-aplikacionin për regjistrim, i cili merret në Kolegj;
 - Dokumentacionin origjinal të shkollimit paraprak;
 - Një fotografi të formatit 3.5 × 4.5 cm;
 - Fletëpagesën për këstin e parë të pagesës së studimeve në vlerë prej 20% të tarifës së shkollimit për një vit akademik.
3. Me rastin e regjistrimit, kandidatët nënshkruajnë kontratën me Kolegjin.
4. Regjistrimi i kandidatit të pranuar konsiderohet i përfunduar dhe i vlefshëm vetëm pas përmbushjes, brenda afatit të përcaktuar për regjistrim, të të gjitha kërkesave të parapara me këtë konkurs, përfshirë dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar, nënshkrimin e kontratës së studimit me Kolegjin dhe pagesën e këstit të parë në vlerë prej 20% të tarifës vjetore të shkollimit për programin përkatës të studimeve.
5. Kandidati i pranuar i cili, brenda afatit të përcaktuar për regjistrim, nuk i përmbush kërkesat e mësipërme dhe/ose nuk e kryen pagesën e këstit të parë, konsiderohet se ka hequr dorë nga e drejta e regjistrimit. Vendi i liruar plotësohet sipas renditjes në listën përfundimtare të kandidatëve, duke respektuar kuotën përkatëse të pranimit.

VIII. INFORMATA SHITESË

Kandidatët mund të marrin informata shitesë:

- drejtpërdrejt nga zyrtarët përgjegjës të programeve të studimit në fakultetet përkatëse të Kolegjit;
- përmes telefonit: 038-544-754, prej orës 09:00 deri në 19:00;
- përmes e-mailit: info@rezonanca-rks.com;
- përmes ueb-faqes zyrtare: www.rezonanca-rks.com.